**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**Kuvendi i Komunës**
**-Komiteti për Politikë dhe Financa-**

*01Nr. 06-350/02-8709/20*
*Kaçanik, 24.02.2020*

Në bazë nenit 10.5 (b) të Ligjit nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, të nenit 3 lidhur me nenet, 6.3 dhe 7.1(b) të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të Vendimit 01Nr.327/09 të Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës: 30.01.2009 -Për Delegimin(Bartjen) e Kompetencës për ndërrimin e destinimit të sipërfaqeve të vogla të klasës së pestë(V-të) dhe të gjashtë(VI-të) të tokës bujqësore në atë ndërtimore në Komitetin për Politikë dhe Financa, të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit Nr. 06 Nr. 350/02-8709/20 të datës 20.02.2020, Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 24 Shkurt 2020, mori këtë:

**V E N D I M**
**PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMITTË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

**1.** Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/02-8709/20 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të **BAJRAM GURI** nga f. Nikaj.

**2.** Toka e përcaktuar për ndërrimin e destinimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, Lejohet: në sipërfaqe, **400m²**, në Parcelën Kadastrale **00404-0** në sipërfaqe të përgjithshme 400m², Zona Kadastrale Nikaj, me kulturë, Arë e klasës së 5(Pestë), pronë private në emër të Bajram(Hilmi) Guri, sipas Certifikatës së pronës me Nr. 70917064-00404-0.

**3.** Parcela Kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, sipas arsyetimit të DUKMM, me Planin Zhvillimor Komunal në fuqi parashihet "tokat bujqësore" ndërkaq me këtë Vendim i ndërrohet destinimi nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore dhe e njëjta bëhet pjesë përkatëse e PZHK.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Propozim Vendimi i DUKMM me pjesën arsyetuar, Certifikata e pronës, Kopja e Planit, Procesverbali i komisionit dhe Kërkesa e palës.

**5.** Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) për hartimin dhe publikimin e akteve në Komuna ndërsa do të zbatohet pas pagesës së tarifave dhe ngarkesave administrative për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të përcaktuara si në Rregulloren komunale -Për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale

**6.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

**Me këtë Vendim njoftohen**: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevantë), Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

**Komuna Kaçanik**
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

**Drejtoria e Urbanzimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**
06.Nr.350/02-8709/20
Kaçanik, 20.02.2020

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika b të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësor, lidhur me kërkesën 06.Nr.350/02-8709/20, e datës 28.01.2020, procesverbalin e komisionit i datës 20.02.2020 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

**Propozon**

Komiteti për Politikë dhe Financa, që lidhur me kërkesën e Bajram Guri nga fshati Nikaj për ndërrim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr:

**VENDIM**

**Miratohet** kërkesa 06.Nr.350/02-8709/20 e datës 28.01.2020 e parashtruar nga Bajram Guri për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, në sipërfaqe prej 400 m², në parcelën kadastrale nr.P-70917064-00404-0 zona kadastrale Nikaj, me kulturë arë e klasës 5, me sipërfaqe të përgjithshme 400 m² pronë private në emër të Bajram Guri.

**Arsyetim**

Bajram Guri nga fshati Nikaj, komuna Kaçanik i ka parashtruar kërkesë këtij organi që t'i lejohet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, në dokumentat e bashkangjitura ka sjellë kërkesën për ndërrim destinimi, fletën poseduese dhe kopjen e planit.
Sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela në fjalë është paraparë si **"tokat bujqësore"**.

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, propozon që Kuvendi Komunal përmes Komitetit për Politikë dhe Financa të merr vendim për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Drejtori i drejtorisë
Ukshin Çallaku

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

KAÇANIKU

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

## Komisisioni për ndrrim destinimi të tokës bujqësore

| | |
|---|---|
| DATË: | 20.02.2020 |
| REFERENCË: | 06Nr.350/02-8709/20 |
| PËR: | z. Ukshin Çallaku, Drejtor I DUKMM-së |
| CC: | |
| PËRMES: | |
| NGA: | Komisioni:1.Mustafë Loku<br>2. Rakip Vishi<br>3.Arditë Shehu |
| TEMA: | **Proqesverbal lidhur ndrrimin e destinimit të tokës bujqësore në ng.00404-0** |

I përpiluar më datën 20.02.2020 lidhur me kërkesën **06Nr.350/02-8709/20** të datës 28.01.2020 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtori i DUKMM-së Ukshin Qallaku, lidhur me kërkesën e paraqitur këtij organi nga **z. Bajram Guri** për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore .

Lidhur me kërkesën komisioni ka dalur në vendin e shiqimit dhe ka konstatuar siç vijon:

Bazuar sipas çerifikatës me nr.të lëndës **941-1835/2020** , Zona kadastrale Nikaj ng. nr.P-70917064-00404-0 me kulturë arë i Kl 5, pronë private, evidentuar në emër të parashtruesit të kërkesës.

Parcela ne fjalë gjindet në fshatin Nikaj, në anën e majtë të rrugës lokale Kaçanik – Soponicë, (42 m nga rruga), e përcjellur me rrugë të pa kategorizuar, sipas gjendjes faktike livadh dhe tokë e papunuar - djerrinë, në afërsi të parcelës ka të ndërtuara shtëpi të banimit,.

Komisioni rekomandon Drejtorinë e lartëcekur që parashtruesit të kërkesës t'i lejohet ndrrimi i destinimit të tokës bujqësore në sip. prej 400 m² siç është cekur në kërkesë, pasi që parcelat në fjalë me kohë kanë humbur karakterin bujqësorë pasi që në të gjitha anët është e rrethuar me shtëpi banimi.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917064-00404-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **941-1835/2020** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 17.01.2020 - 15:02 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Kaçanik / Kaćanik / Kaçanik |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70917064-00404-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë private / Privatna Imovina / Privatelly owned Land | | **2908** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| NIKA PADINA/NIKA PADINA/NIKA PADINA | | NIKA PADINA | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * REPUBLIKA KOSOVO * OPŠTINA KAČANIK

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klase/5th Class Arable Land | **2908** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | **GURI BAJRAM (HILMI)** | 1004455564 | NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ / | | | **1/1** | 66/2017 | 28.02.2017 |

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosova**

***Qeveria -Vlada-Government***

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Nikaj

06-941-1834

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-70917064-00404-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2908,0 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:524

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 17.01.2020

Koha/ Vreme/ Time: 03:07:03

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: ______________________

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: ______________________

REPUBLIKA E KOSOVËS

**0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë**

Drejtorati / Njesia

**Urbanizmit,Kadaster dhe Mjedis**

Data 28/01/20 (dita / muaji / viti)

KAÇANIKU

**1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:**

| Emri dhe mbiemri | Lloji dhe numri i dokumentit identifikues |
|---|---|
| Bajram Avuri | |

| Data e lindjes (dita / muaji / viti) | Adresa e vendbanimit (numri i shtëpisë/banesës, rruga, fshati/qyteti, kodi postar) |
|---|---|
| | Dikaj |

| Numri i tel. fiks | Numri i tel. mobil | E-mail adresa |
|---|---|---|
| | | |

**Mos shkruani në**

| | |
|---|---|
| Pranuar nga: | |
| Numri i protokollit: | 06-350/02-2709/20 |
| Vendimi: | po |
| Nga: | |
| Data: | |

**2 Selekto llojin:**

Kërkesë ☑ Ankesë ☐

**3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kërkojmë nga juve që të më lejojë ndërrimin destinimin për 450m² në p.k. 404-0 z.k. Dikaj. ~~në~~ Toka është me kulturë arë e kl. 5-të.

**4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Bajram Avuri (Emri i plotë i aplikuesit) vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta. [signature] (Nënshkrimi)

*** Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura ***